



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 198/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

V E N D I M

Konstatohen të tërhequra ankesat me numër: Anr.169/2013, Anr.170/2013 Anr. 173/2013, Anr.181/2013, Anr.182/2013 dhe Anr.184/2013 të datës 07.10.2013, të parashtruara në PZAP nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Arsyetim

PZAP, me datë 07.10.2013, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesave me numër: Anr.169/2013, Anr.170/2013 Anr.173/2013, Anr.181/2013, Anr.182/2013 dhe Anr.184/2013 të datës 06.10.2013, të parashtruara në PZAP kundër subjektivit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën kërkohet që të tërhiqen ankesat e lartpërmendura nga shqyrtimi, në qoftë se të njëjtat nuk janë shqyrtuar deri në momentin e paraqitjes së kërkesës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesave të sipërsënuara, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohen ankesat në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 198/2013 më datën 09.10.2013

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

